

Rami MEMUSHAJ

PRURJE TË REJA NË FUSHËN E GRAMATIKËSISË SHQIPES*

(M. Çeliku, *Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)*,
ILAR Tiranë, 2012, 439 f.; *Parafjalët e shqipes standarde*, ILAR, Tiranë, 2019, 427 f.)

Abstrakti: Me hapjen e Shqipërisë dhe shpërthimin e gardheve ideologjike që shkaktuan mbylljen e shkencave shqiptare, përfshirë edhe gjuhësinë, në këtë fushë fillimi i shekullit të ri karakterizohet nga përpjekjet për t'u njohur me zhvillimet e arritjet në gjuhësinë botërore dhe për t'i parë dukuritë e shqipes në dritën e teorive bashkëkohore. Sidomos këta dy dhjetëvjeçarët e fundit nga studiuesit tanë janë bërë përpjekje për të përvetësuar e përdorur në përshkrimin e shqipes metodat dhe teknikat e gjuhësisë bashkëkohore. Ndër gjuhëtarët që kanë bërë përpjekje të suksesshme në këtë drejtim, shquhet prof. dr. Mehmet Çeliku. Duke vijuar në rrugën e nisur qysh në të ri të tij si gjuhëtar me mendim kritik dhe i prirë për zgjidhje origjinale të një vargu çështjesh të gramatikës së shqipes, ai, edhe pse në një moshë kur shumë nga kolegët e tij e kanë lënë gjuhësinë, nuk ka reshtur së punuari. Ndër prurjet shkencore të tij spikatin veçanërisht dy veprat teorike të botuara këta dhjetë vjetët e fundit: “Sintaksa e gjuhës shqipe” (2013) dhe “Parafjalët e shqipes standarde” (2019). Pikërisht këto dy vepra do të jenë objekt i këtij shqyrtimi.

Fjalë kyç: parafjalë, përbërës, parapërbërës, sifjali, parasifjali, sintaksë, thënie, valencë.

I.

Pas përmbysjes së regjimit totalitar dhe hapjes së Shqipërisë ndaj botës, në gjuhësinë shqiptare, që u çlirua nga kufizimet ideologjike, të cilat e kishin mbyllur dhe e kishin lënë shumë prapa, nisën përpjekjet e shumë gjuhëtarëve për t'u njohur me zhvillimet në gjuhësinë botërore. Sigurisht që ky proces nuk ka qenë i lehtë, sepse, për të zbatuar metoda të reja, duhen njohur më parë konceptet që qëndrojnë në bazë të këtyre metodave. Pikërisht, për këta gjuhëtarë dhjetëvjeçari i fundi i shekullit që shkoi shërbeu si periudhë e përditësimit të njohurive gjuhësore dhe e përvetësimit e përdorimit në përshkrimin e shqipes të metodave dhe të teknikave të gjuhësisë bashkëkohore. Frytet e para i takojnë fillimit të shekullit të ri, kur nisi botimi i teksteve universitare që pasqyronin zhvillimet në gjuhësinë perëndimore. Duke u hedhur një sy këtyre 20 vjetëve, vërejmë se ka zhvillime e prurje të reja, që shënojnë kthimin e gjuhësisë sonë në shtratin e gjuhësisë botërore.

Këto përpjekje janë më të dukshme veçanërisht në fushën e sintaksës, e cila kishte mbetur më prapa fushave të tjera. Janë botuar monografi, tekste universitare e artikuj, janë mbrojtur tema magistrature e doktorata në të cilat dukuritë sintaksore të gjuhës sonë shihen në frymën e gjuhësisë gjenerative. Këtyre prurjeve në këtë fushë vjen u shtohet edhe vepra “Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)”, që po i jepet në dorë lexuesit. Autori i saj, prof. Mehmet Çeliku, është një zë i njohur i gjuhësisë shqiptare, që gjatë një periudhe 50-vjeçare ka sjellë ndihmesa të çmuara në fushën e dialektologjisë, të morfologjisë, të sintaksës dhe të kulturës së gjuhës. Në shkrimet, monografitë dhe tekstet e tij gjejmë shumë vështirime të mprehta dhe

trajtime të guximshme e tepër origjinale të dukurive morfologjike e sintaksore, që shpeshherë kanë ngjallur edhe diskutime e mospranime.

Ajo që e dallon M. Çelikun nga gjuhëtarët shqiptarë të brezit të tij, është prirja për të përqafuar të renë, të dëshmuar me punën e tij të palodhur për përditësimin e dijeve dhe të formimit të vet gjuhësor. Për prof. M. Çelikun, periudha deri në daljen e kësaj vepre ka qenë një periudhë përpjekjesh për të njohur zhvillimet më të fundit në fushën e sintaksës, me qëllim që të arrinte në bindje të qëndrueshme lidhur me nevojën e një vështrimi të ri të sintaksës së gjuhës shqipe. Si një studiues që ka dhënë jo pak prova të një mendimi shkencor të pavarur e të guximshëm, ai nuk ka mbetur në llogoret e vjetra. Skepticizmi i tij ndaj ideve të reja dhe ngurrimi për t'i përqafuar ato nuk janë ato të një kundërshtari të palëkundur të tyre, po të një kërkuesi që nuk i pranon pa i asimiluar konceptet e reja të gramatikës strukturaliste e gjenerative. Duke u njohur me literaturën sintaksore të kohës, duke diskutuar e debatuar në sesione e konferenca gjuhësore rreth zhvillimeve në këtë fushë, prof. Çeliku ka arritur të kthjellohet për domosdoshmërinë e pranimin dhe të zbatimit të shumë koncepteve të reja që tashmë kanë bërë udhë në studimet sintaksore të shqipes. Libri "Sintaksë e gjuhës shqipe (përbërësit sintaksorë)" është pikërisht fryt përpjekjeve të autorit për të kaluar në filtrin e kritikës konceptet sintaksore të gjuhësisë tradicionale dhe për të futur në përshkrimin e shqipes koncepte e këndvështrime të reja.

Lënda gjuhësore e vëllimshme prej 439 faqesh e kësaj vepre përfshin parathënien, pesë krerë, përfundimet, treguesin e termave dhe bibliografinë. Në kreun e parë "Disa nocione bazë në fushë të sintaksës teorike" (f. 1-45), trajtohen koncepte e terma të sintaksës strukturaliste, si sintagma dhe përbërësi sintaksor, llojet e përbërësve sintaksorë, statusi i kryefjalës, i trajtave të shkurtra të përemrave, i kallëzuesorëve, i kallëzuesve emërorë dhe i formave të pashtëlluara. Edhe kreu i dytë "Përbërësit sintaksorë" (f. 47-128) mund të shihet si vijim i të parit. Në të autori ndërton kuadrin teorik të veprës, duke përcaktuar termat e duke përkufizuar konceptet me të cilat do të operojë në krerët vijues, njësitë sintaksore, tipat e përbërësve sintaksorë dhe marrëdhëniet kuptimore dhe funksionet e përbërësve në fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë. Kreu i tretë "Funksionet gramatikore të përbërësve sintaksorë" (f. 129-275) i kushtohet trajtimit të gjymtyrëve të fjalisë: kallëzuesit, kundrinorëve, rrethanorëve, përcaktorëve dhe ndajshimit, gjymtyrëve të veçuara dhe gjymtyrëve homogjene, fjalëve togjeve dhe fjalive të ndërmjetme e të ndërkallura si dhe rendit të gjymtyrëve në fjalinë e thjeshtë. Kreu u katërt "Fjalitë e thjeshta" (f. 277-331) merret me fjalitë e thjeshta sipas qëllimit të thënies, sipas modalitetit dhe numrit të përbërësve, duke u ndalur në llojet e fjalive njëkryegjymtyrëshe foljore dhe emërore, në fjalitë e paplota dhe në fjalitë pa përbërës sintaksorë. Kreu i pestë "Fjalitë e përbëra (periudhat)" (f. 333-414) u kushtohet fjalive të përbëra, duke marrë me radhë llojet e fjalive bashkërenditëse dhe të fjalive nënrenditëse. Më tej vijnë "Përfundimet" (f. 405-424), që janë përkthyer edhe anglisht, treguesi i termave (f. 427-429). Libri mbyllet me bibliografinë (431-439), që përmban një listë të pasur të literaturës teorike të shfrytëzuar në shqipe dhe në gjuhë të huaja.

Në dallim nga librat për sintaksën në frymën e gjuhësisë gjenerative të botuar deri tani, të cilët si monografi janë marrë me çështje të veçanta të sintaksës, kurse si tekste teorike nuk janë thelluar në sintaksën e shqipes, ky libër synon të jetë një trajtesë e re e sintaksës së shqipes, e

para vepër që ngërthen gjithë problematikën e kësaj fushe. Një punë të tillë mund ta kryente vetëm një gjuhëtar që është marrë me çështjet e morfologjisë dhe të sintaksës së shqipes, në artikuj, monografi, tekste akademike e mësimore. Vetëm një studiues me këtë përvojë si M. Çeliku mund të guxonte të ndërmerre një përpjekje të tillë për t'u thelluar në studimin shkencor të strukturës sintaksore të shqipes e për të arritur në interpretime sa më të pranueshme të disa çështjeve të diskutueshme e problemore të saj, duke u mbështetur në konceptet e gjuhësisë moderne, në sintaksën teorike strukturaliste, që e sheh gjuhën si strukturë, si sistem shenjash e lidhjesh të përbërësve sintaksorë.

Po të kemi parasysh ndihmesat e shumta të prof. M. Çelikut në fushën e morfologjisë dhe të sintaksës, dalja në dritë e kësaj veprë nuk është diçka e papritur. E "papritur" është përpjekja e lavdërueshme e autorit, të formuar në kuadrin e gjuhësisë tradicionale, për t'u orientuar nga gjuhësia e sotme. Kjo duket në atë që si njësi bazë të përshkrimit sintaksor ai nuk merr togfjalëshin, për të cilin pranon se është një kategori e ngushtë, po përbërësin, që është gjithëpërfshirës. Me braktisjen e togfjalëshit si njësi të përshkrimit sintaksor, kjo vepër shënon edhe fundin e sintaksës tradicionale dhe orientimin drejt sintaksës bashkëkohore.

Përbërësi i fundit sintaksor i M. Çelikut nuk është krejt ai i Blumfildit, i cili në analizën e fjalisë nuk bën dallim midis përbërësit morfologjik dhe atij sintaksor, po diçka midis përbërësit të Blumfildit dhe sintagmës X-bar të gjenerativistëve. Analiza në përbërës është analizë strukturore; ndryshe nga analiza në togfjalëshin, që e sheh fjalinë si lidhje lineare gjymtyrësh, analiza në përbërës tregon se përbërësit sintaksorë nuk lidhen në mënyrë lineare, po hierarkike. Ajo arrin të zbulojë edhe funksionet sintaksore të përbërësve të fundit, siç na dëshmohej në faqet e këtij libri. Përbërësi, që shërben si njësi bazë e analizës sintaksore të bërë në veprën "Sintaksë e gjuhës shqipe", është, në thelb, sintagma e gramatikës gjenerative. Ashtu si dhe skema X-bar e sintagmës, edhe përbërësi sintaksor i këtij libri ka kokë dhe caktuesorë. Por kategoria e caktuesorit zgjerohet, duke përfshirë në të jo vetëm specifikuuesin e skemës X-bar të Çomskit, dmth. caktuesorin në kuptimin e ngushtë, si element që qëndron në të majtë të kokës, po edhe plotësorët që qëndrojnë në të djathtë të saj (kundrinat, rrethanorët, përcaktorët), të cilët i quan "shoqërues". Më tej, edhe vetë kategoria e caktuesorit në kuptimin e ngushtë zgjerohet duke përfshirë në të edhe përsëritjet e kundrines, gjë që lë vend për diskutime. Në këtë mënyrë, autori ndalet në pragun e sintaksës gjenerative.

Analiza sintaksore në përbërës që zbatohet në këtë libër, nuk është formale si ajo e deskriptivistëve. Mbështetja në teorinë e sintagmës, të valencës dhe të thënies i kanë bërë të mundur autorit t'i analizojë njësitë gjuhësore jo vetëm nga ana strukturore, por edhe nga ana semantike. Pra, ai nuk është mbështetur vetëm në një drejtim gjuhësor të caktuar, bie fjala, në deskriptivizmin amerikan ose në gjuhësinë strukturaliste europiane, në funksionalizëm ose në gjenerativizëm, po ka përvetësuar prej këtyre traditave gjithçka që i është dukur racionale dhe që, për mendimin e tij, i shkon natyrës së shqipes. Njohja e arritjeve të gjuhësisë së sotme i ka lejuar autorit të vështrojë dhe të rivlerësojë me syrin kritik arritjet e mëparshme në studimet sintaksore të gjuhës shqipe, duke vënë në dukje vlerat pozitive, po edhe të metat e tyre. Duke u përpjekur të kapërcejë mangësitë e përshkrimit sintaksor të bërë në kuadrin e teorisë së togfjalëshit, autori na jep një sintaksë të re të shqipes, me mjaft qëndrime e trajtime vetjake të

dukurive, shumë të argumentuar e të ilustruar mjaftueshëm me material gjuhësor nga të gjitha format e ligjërimit me shkrim e me gojë.

Risitë e kësaj vepre në krahasim me sintaksën e Akademisë janë të shumta. Së pari, ndryshe nga sintaksa akademike, e cila operon me togfjalëshin, në këtë vepër kjo njësi braktiset dhe futet koncepti i përbërësit, duke u afruar me gramatikën strukturaliste; po ashtu, ndërsa sintaksa tradicionale pranon tri njësi: gjymtyrën e fjalisë, togfjalëshin dhe fjalinë, kjo sintaksë pranon vetëm dy njësi: fjalinë dhe përbërësin, i cili, ashtu si në sintaksën strukturaliste e gjenerative, është i shkallëzuar, dmth. i zbërthyeshëm në përbërës më të vegjël. Së dyti, në këtë gramatikë semantikës sintaksore i jepet më shumë vend se në sintaksën e Akademisë dhe shumë më tepër se në sintaksën gjenerative, gjë që është arritur duke e parë fjalinë edhe nga perspektiva e realizimit të saj në ligjërimit. Së treti, pranohet koncepti i valencës dhe, lidhur ngushtë me të, plotësorët shihen të kushtëzuar nga valencat e foljes, duke pranuar edhe përshkallëzimin e tyre sipas domosdoshmërisë. Së katërti, krahas aspektit gramatikor e semantik, shtohet edhe aspekti pragmatik, duke dalluar fjalinë si njësi abstrakte të gjuhës nga thënia si realizim konkret i fjalisë në situata të ndryshme ligjërimore, ku hyjnë në lojë intonacioni dhe mjete të tjera të aktualizimit të thënies. Së pesti, nëpërmjet përfshirjes intonacionore, integrohen në fjali thirrori, ndërtimet e ndërmjetme e të ndërkallura, duke mos i parë më si elemente periferike të fjalisë; po ashtu, krahasorët shihen si një gjymtyrë tjetër e varur e fjalisë, në një shkallë me kundrinorët, përcaktorët dhe rrethanorët. Së gjashti, nuk pranohet përcaktori kallëzuesor si gjymtyrë e fjalisë, çka përbën një qëndrim më të hershëm të autorit rreth kësaj kategorie të sintaksës tradicionale, qëndrim që e kemi mbajtur edhe ne më parë¹; në përputhje me këtë, kallëzuesit e tipit *u emërua nëpunës, miza u bë buall* përfshihen si nëngrup të kallëzuesi emëror. Së shtati, duke u nisur nga funksioni i njëjtë sintaksor, vendoset paralelizmi midis gjymtyrëve të thjeshta dhe sifjalive, duke i trajtuar edhe këto si përbërësit e thjeshtë sintaksorë dhe duke e bërë analizën e sifjalive të periudhës njëlojë si të përbërësve të fjalisë së thjeshtë, si dhe duke e mbështetur klasifikimin e periudhave të lidhjet e përbërësve të tyre etj.

Risi ka jo vetëm në për sa i përket e konceptimit, po edhe në fushën e terminologjisë. Autori jo vetëm merr terma që kanë hyrë në studimet tona sintaksore, si *përbërës, caktuesor, plotësor*, po krijon edhe një varg termash të vetët, si *kryepërbërës, krahasor, sifjali, shoqërues, shtesor* etj. Këto risi ia shtojnë edhe më kësaj vepre shkallën e origjinalitetit.

Veç risive që numëruam më sipër, në këtë libër ka edhe çështje të diskutueshme. Për mendimin tonë, një çështje e tillë është, për shembull, pranimi i marrëdhënieve kallëzuesore si një lloj lidhjeje kuptimore e përbërësve kryesorë të fjalisë, gjë që bie në kundërshtim me natyrën e përbërësit. Sikundër dihet, përbërësit janë konstrukte endocentrike, dmth. kryepërbërësi trashëgon kategorinë leksiko-gramatikore të përbërësit që shërben si kokë e tij. Mirëpo lidhja kryefjalë-kallëzues është një ndërtim ekzocentrik, pasi fjalia si kryepërbërës nuk trashëgon asnjë prej vetive të kallëzuesit, që shërben si kokë e saj, as të kryefjalës. Një pikë tjetër e diskutueshme është ajo e kundrinorëve të zhdrejtë me parafjalë, koncepti i sintaksës akademike, nga i cili nuk

¹ Duke mos e njohur përcaktorin kallëzuesor si gjymtyrë fjalie, ne nuk kemi pranuar si kategori më vete edhe kallëzuesin emëror, duke i përfshirë si kallëzuesit e tipit *është mësues*, edhe të tipit *u emërua mësues* të kallëzuesit e përbërë (R. Memushaj, *Bukuria e gjuhës*, III, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Podgoricë, 2008, f. 106).

është shkëputur dot autori. Megjithëse operon me konceptin e valencave, ai pranon kundrinorë me parafjalë edhe për folje njëvalente që nuk mund marrin argument të brendshëm, si format pësore (u ndërtua nga punëtorët, u shkëput nga familja etj.), ose folje si *vete* (kishte vajtur me gruan), *anoj* (ai anon nga prindërit) etj.

Vepra “Sintaksë e gjuhës shqipe” e prof. M. Çelikut është libri i parë i plotë dhe i përditësuar i sintaksës së gjuhës sonë që del rreth 40 vjet pas botimit të parë dhe të vetëm të gramatikës së Akademisë së Shkencave. Në mungesë të një sintakse të re akademike ose të një teksti tjetër të përditësuar, ky libër është më i miri i dhe më i ploti për sintaksën e shqipes i botuar deri më sot dhe për këtë arsye u duhet këshilluar ta përdorin pedagogët e specialistët e rinj të gjuhës shqipe, studentët universitarë e pasuniversitarë dhe mësuesit e gjuhës shqipe në të gjithë hapësirën ku flitet dhe mësohet shqipja si gjuhë amtare. Koncepte themelore të saj duhet të depërtojnë edhe në tekstet e gjuhës shqipe për shkollën 9-vjeçare e të mesme, në mënyrë që të mos ketë më tekste ku sintaksa të mbështetet në konceptin e togfjalëshit.

Vlera e këtij libri nuk qëndron vetëm në aspektin njohës, por dhe në atë metodologjik: botimi i një vepre të tillë nga një gjuhëtar i brezit të vjetër shënon *de facto* fundin e sintaksës tradicionale. Me daljen e saj, çdo përpjekje për studime e analiza sintaksore në frymën e kësaj të fundit do të ishte me vlera të diskutueshme, për të mos thënë e pavlerë. Risetë e përmendura më sipër të “Sintaksës” së prof. Çelikut e bëjnë këtë libër një vepër origjinale, që i shtohet vargut të pakët të veprave shqip të shkruara në frymën e gjuhësisë së sotme. Pavarësisht nga vërejtjet dhe sugjerimet që mund të bëhen për qëndrime, zgjidhje e terma, nuk mund të mohohet që ky libër përbën një ndihmesë të vyer të autorit në fushën e sintaksës së shqipes dhe një arritje me vlerë që i ndihmon afrimit të gjuhësisë shqiptare me gjuhësinë e sotme botërore.

Më në fund, por jo e fundit, do të shtonim se përpjekja e prof. M. Çelikut për të dhënë një vepër përgjithësuese, si një sintezë të ndihmesave të tij në fushën e studimeve gramatikore, është e para e këtij lloji në gjuhësinë shqiptare. Ky është një shembull që duhet ndjekur nga gjuhëtarët shqiptarë me përvojë të gjatë kërkimore edhe në fusha të tjera, si në morfologji, në fjalëformim, në drejtshkrim etj.

Pas hedhjes në qarkullim të librit dhe vlerësimit të tij nga kritika gjuhësore, çka do t’i lejonte autorit të kthjellohej dhe të bëhet më koherent në qëndrimet dhe në zgjidhjet e dhëna, mendoj se duhet parë mundësia e përkthimit të saj në gjuhën angleze, çka do të përbënte një ndihmesë tjetër të autorit për t’u dhënë albanologëve të huaj një libër për sintaksën e shqipes, që u ka munguar deri më sot.

Fryma risuese vërehet edhe në veprën e fundit “Parafjalët e shqipes standarde”, një punim model për trajtimin e një pjese të ligjëratës. Deri më sot, me përjashtim të mbiemrit, që është përshkruar shterueshëm në dy monografi¹, asnjë pjesë tjetër e ligjëratës të gjuhës shqipe nuk është trajtuar në mënyrë të plotë; janë para herë aspekte të fjalëformimit, herë aspekte të tjera të emrit, foljes dhe të ndajfoljes.

² A. Dhimo, *Mbiemrat në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2017, 326 f.; Xhafer Beqiraj, *Funksionet semantiko-sintaksore të mbiemrit në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2016, 346 f.

II.

Monografia “Parafjalët e shqipes standarde” (2019) është punimi tjetër më i ri i prof. M. Çelikut, në 390 faqe të të cilit trajtohet në mënyrë shteruese nga pikëpamja leksikore, morfologjike e semantike kjo pjesë e ligjëratës. Lënda e saj është ndarë në katër krerë, që mbyllen me listën e plotë të parafjalëve të trajtuara, me përfundimet shqip e anglisht, me bibliografinë dhe me listën e veprave të vjela prej autorit. Është një punim jo vetëm i ri, po edhe origjinal, sidomos po të kemi parasysh se në studimin e parafjalëve të shqipes kontributet kryesore janë të autorit të kësaj monografie, ndërkohë që ndihmesat e autorëve të tjerë janë fare të pakta. Është punim origjinal si nga struktura, sepse nuk ka pasur një model të cilit t’i përmbahej; është punim origjinal edhe nga përmbajtja, sepse përmban një varg idesh të reja, që janë parashtruar prej tij edhe në punimet e mëparshme kushtuar parafjalëve.

Kreu i parë “Çështje teorike të parafjalëve” (f. 13-85) merret me problemet teorike që paraqet studimi i parafjalëve, si me natyrën leksiko-gramatikore të parafjalëve, me përqasjen e tyre me servitudat gramatikore (lidhëzat, nyjat e pjesëzat trajtëformuese), me strukturat e sintagmave parafjalore (autori, në përputhje me qëndrimin e mbajtur në “Sintaksën” e tij, i quan “përbërës me parafjalë”), duke vijuar pastaj me klasifikimin e parafjalëve dhe me çështje të karakterit teorik e terminologjik dhe duke përfunduar me disa çështje problemore, si përdorimi i rasës emërore me parafjalë, që përbën një dukuri karakteristike të shqipes, trajtimi i fjalëve lidhëse si, se/sesa, sa (të cilat i sheh të afërta nga funksioni me parafjalët dhe propozon për to termin “parapërbërës”), parafjala me e përdorur si lidhëz bashkërenditëse (me = dhe), dhe zhvillimi i sistemit parafjalor të gjuhës shqipe, duke e mbyllur me një vështrim panoramik të trajtimit të sistemit parafjalor të shqipes në gjuhësinë shqiptare.

Kreu i dytë “Parafjalët njëfjalëshe (parafjalët e thjeshta)” (f. 87-237), që është më i vëllimshmi, i kushtohet trajtimit të njëpërnjëshëm të parafjalëve njëfjalëshe sipas rasave, duke nisur me parafjalët e parme, pastaj me të prejardhurat, duke dalluar brenda tyre nënklasa të tjera sipas pjesës së ligjëratës nga vijnë, dhe të përngjiturat. Për çdo parafjalë trajtohen me hollësi llojin e marrëdhënieve që tregon si dhe përdorimet, të ilustruara për çdo përdorim me shembuj të mjaftueshëm.

Kreu i tretë “Lokucione parafjalore (parafjalët komplekse)” (f. 329-309) çelet me një vështrim të përgjithshëm të tipareve dhe nënlojeve të lokucioneve parafjalore, të drejtimit nga folja të ndërtimeve të shprehura me lokucion parafjalor plus formë rasore e emrit (u kthye në drejtim të erës) si dhe të identitetit të parafjalëve të prejardhura dhe të lokucioneve parafjalore. Pastaj kalohet në shqyrtimin e lokucioneve dykomponentëshe (emërore, foljore, ndajfoljore dhe me dy parafjalë të parme) dhe trikomponentëshe të tipit në lidhje me etj.

Kreu i katërt (f. 311-368) përmban listën e plotë të parafjalëve të shqipes standarde.

Libri mbyllet me përfundimet në shqip dhe anglisht, me listën bibliografike të literaturës së shfrytëzuar, me listën e veprave letrare të vjela dhe me një pasqyrë shkurtesash të termave të përdorura në punim.

Në 21 faqet e “Përfundimeve” jepen në mënyrë të përmbledhur pikëpamjet e shtjelluara prej autorit në këtë vepër, që janë vijim e konkretizim i ideve të hedhura prej tij që në artikujt e viteve ‘70 të shekullit të kaluar kushtuar parafjalëve. Parafjalët shihen prej autorit si fjalë

gramatikore që kryejnë funksione të ngjashme me mjetet e tjera eptimore që ndërtojnë format e fjalëve, siç janë ndajshitesat eptimore, nyjat e përparme, pjesëzat trajtëformuese e fjalët e shkallës, me të cilat nganjëherë dublohet. “Dallimi kryesor midis sistemit eptimor dhe sistemit parafjalor”, sipas autorit, qëndron në atë që të parat janë mjete që ndërtojnë format gramatikore të fjalëve duke shprehur edhe kuptimet gramatikore të tyre, ndërsa parafjalët shërbejnë për të lidhur me nënrenditje format e fjalëve, prandaj autori i klasifikon si fjalë gramatikore funksionale. Nisur nga ky funksion, autori sheh te parafjalët ngjashmëri me lidhëzat nënrenditëse, si “dy nënklasa fjalësh shumë të ngjashme të një klase të vete”, me dallimin që fusha e veprimit të parafjalëve është fjalia ose sifjalia, përderisa lidhin gjymtyrë, ndërsa fusha e veprimit të lidhëzave nënrenditëse është periudha. Si rrjedhim, duke parë afrinë e këtyre dy klasave dhe dallimin e lidhëzave nënrenditëse nga bashkërenditëset, që lidhin gjymtyrë ose sifjali të barasvlefshme, autori propozon një ndarje të re për parafjalët e lidhëzat. Parafjalët dhe lidhëzat i fut në grupin e *parapërbërësve* (parasintagmave), që ndahet në nëngrupin e parafjalëve dhe të *parasifjalive* (lidhëzat nënrenditëse) dhe në grupin e lidhëzave bashkërenditëse. Pra, kemi jo vetëm një ndarje të re, po edhe terma të rinj.

Risi të tjera të kësaj vepre janë se lokucionet parafjalore që kërkojnë gjinoren (në drejtim, për shkak etj.) autori i merr pa nyjën e përparme *të*, sikundër bëjnë të tjerë, dhe pranon kështu parafjalë të rasës gjinore. Po ashtu, autori pranon edhe parafjalë të rasës dhanore, krahas atyre të rrjedhore, dhe si argument për këtë sjell faktin që, sipas tij, sot vërehet prirja që parafjalët të lidhen me formën rasor të dhanores (*rrëzë malit* në vend të *rrëzë maleve*). Gjinatorja është rasë që merr parafjalë, por dhanorja jo. Forma *rrëzë malit* është rrjedhore, pavarësisht nga sinkretizmi i formave rasore të rrjedhore me dhanoren dhe argumenti për këtë është që emri në këtë formë po pa parafjalë funksionon si rrethanor (*doli malit*), ndërkohë që në të gjitha gjuhët me rasa dhanorja kryen vetëm funksionin e kundrinës së zhdrejtë të foljeve me dy ose tri valenca (*i bie me top malit*).

Duke i mbyllur “Përfundimet”, autori këshillon që në fjalorët e shqipes lokucionet parafjalore të jepen si leksema më vete e jo te fjala kryesore e tyre, çka e shohim si zgjidhje të drejtë.

Në fund të librit është një pashënie e shkurtër, në të cilën studimin “Parafjalët e shqipes standarde” autori e quan “produkt shkencor të jetës e të familjes”, sepse hartimi i tij ka filluar 50 vjet më parë me artikuj kushtuar parafjalëve dhe se në hartimin e tij kanë marrë pjesë edhe bashkëshortja dhe i ndjeri djali i tyre Florenti, të dy studentë të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë të Universitetit të Tiranës dhe të dy autorë temash diplome kushtuar parafjalëve. Dhe, për ta dëshmuar këtë, jep të skanuara disa faqe nga tema e diplomës e F. Çelikut “Përdorimi i parafjalëve nga Fan Noli”.

Prof. Mehmet Çeliku nuk e ka lënë punën shkencore me këtë monografi. Ai është duke punuar me vrullin e një të riu dhe me pjekurinë që e karakterizon një njeri me përvojë 60-vjeçare në fushën e kërkimit gjuhësor. Së shpejti do të kemi në dorë një vepër tjetër, të nxjerrë nga arkiva e pasur e këtij punëtori të palodhur të gjuhës shqipe, të cilit s’na mbetet tjetër, veçse t’i urojmë shëndet e mendje të kthjellët për ta hedhur në letër gjithë prodhimin e tij shkencor.